



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

**VENDIM**

***Nr. 9 Datë 30.01.2013***

**MBI**

**ORGANIGRAMËN E RE TË SHOQËRISË CEZ SHPËRNDARJE (NËN  
ADMINISTRIM TË PËRKOHSHËM) TË PROPOZUAR PËR MIRATIM  
ERE-S**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, dhe 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Vendimin nr. 5, date 21.01.2013, “Për vendosjen e shoqërisë CEZ shpërndarje sh.a, ne administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë cez shpërndarje sh.a., në zbatim të vendimit të bordit të komisionerëve të ERE nr. 4, date 21 janar 2013, “Per heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes të energjise elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakice të energjise elektrike të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a.”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës .01.2013, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike të ERE,

**Vendosi:**

1. Miratimin e organigramës së shoqërisë CEZ Shpërndarje sipas organigramës bashkelidhur ketij vendimi.
2. Miratimin e pages së administratorit të perkohshem të shoqërisë CEZ Shpërndarje (Në administrim të përkohshëm), në vlerën e 300.000 leke.
3. Administratori i shoqërisë CEZ Shpërndarje (Në administrim të përkohshëm) të hartojë strukturën e përgjithshme të shoqërisë CEZ Shpërndarje duke përcaktuar: numrin total të punonjësve, numrin e punonjësve për secilën drejtori dhe sektor, të drejtat dhe detyrat e çdo punonjësi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**

**Sokol RAMADANI**

## Organigrama e shoqërisë CEZ Shpërndarje (Nën administrim të përkohshëm)



CEZ SHPERNDARJE